



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**Emri i Biznesit:** "Swiss Plus-1" SH.P.K  
**Numri Unik Identifikues:** 810166274  
**Pronar:** Bujar Berishaj  
**Operatori i Shpërndarjes:** "Swiss Plus-1" SH.P.K.  
**Adresa:** Lladroviq, Malishevë



**VENDIM**

për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes, "Swiss Plus-1" SH.P.K, me seli në Lladroviq, Komuna e Malishevës

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Operatori i Shpërndarjes Swiss Plus-1 SH.P.K është Operatorë i Shpërndarjes, i cili ishte licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes sistemit kabllorë, me seli në Lladroviq, komuna e Malishevës. KPM, me datën 17 qershor 2019, ka marr vendim për dhënien e licencës për për Operatorin e Shpërndarjes "Swiss Plus-1" SH.P.K, me afat prej dhjet (10) viteve.
3. Më datën 05 janar 2023, pronari, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM, ka njoftuar se heqë dorë nga licenca e KPM-së për Operatorin e Shpërndarjes "Swiss Plus-1" SH.P.K
4. Për shkak të mungesës së kuorunit për vendimmarrje të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, kërkesa e kandidatit "Swiss Plus-1" SH.P.K nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.

**Arsyetimi**

5. Për shkak të pamundësisë së vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Mediave për arsye të mungesës së kuorunit, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, kërkesa e "Swiss Plus-1" SH.P.K., nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.

6. Duke u bazuar në njoftimin e pronarit, për heqje dorë nga licenca e KPM-së në mënyrë vullnetare, Komisioni vlerëson se, ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes “Swiss Plus-1” SH.P.K.

### Vendim

7. Komisionit në takimin e datës 17 korrik 2023, vendos për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës të Operatorit të Shpërndarjes “Swiss Plus-1” SH.P.K. sipas njoftimit me shkrim për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga Licenca e KPM-së.
8. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

  
Jeton Mehmeti  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediav



17.07.2023  
datë